



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 730/6 Prot.

Tiranë, më 2/10/2013

Lënda: Rekomandim për kontrolluesin "MITO By Caterina Firenze" shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

REKOMANDIM

Nr. 31 datë 02/10 2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, "MITO By Caterina Firenze" sh.p.k.

KONSTATOVA

Në datë 11/09/2013 Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka zhvilluar kontroll administrativ pranë kontrolluesit, "MITO By Caterina Firenze" sh.p.k. me objekt;

- Ligjshmëria e mbledhjes, përpunimit të të dhënave personale për subjektet e të dhënave personale "punonjës", sipas ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Nga kontrolli i ushtruar rezulton se kontrolluesi është një ndërmarrje fasoneri bashkëpunim me sipërmarrës të huaj Italianë "Alba Moda" në fushën e prodhimit industrial e artizanal të këpucëve, me qendër në qytetin Berat. Në këndveshtrimin e ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, gjatë ushtrimit të aktivitetit tuaj merrni cilësinë e kontrolluesit privat, pasi në punën tuaj mblidhni dhe përpunoni të dhëna personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave "punonjës"

Ligji nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", në nenin 3 përkufizon; "Kontrollues" është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që, vetëm apo së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës, dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj.

Kontrolli administrativ ndaj jush u shtri vetë mbi kategoritë e subjekteve të të dhënave personale "punonjës". Konstatohet se për këtë kategori subjektsh të të dhënave personale ju si kontrollues të dhënat personale të tyre i mblidhni nëpërmjet dokumentacionit që subjektet e të dhënave dorëzojnë në momentin e lidhjes së kontratave të punësimit.

Nga kontrolli administrativ konstatohet se mbledhja përpunimi i këtyre të dhënave nga ju si kontrollues realizohet në rrugë manuale dhe elektronike. Mbledhja e të dhënave në rrugë manuale ka të bëjë me krijimin për secilin punonjës të “kartelës së punonjësit” (dosja e punonjësit), në të cilën rezultoi se mblidhen *ID, librezën e punës, librezën e kontributeve, raportin mjeko ligjor, kontratën me punonjësit.*

Kartelat e punonjësve ruhen prej kontrolluesit për punonjësit që janë aktive dhe për punonjësit e larguar ato ruhen mbi bazën e një rregullimi të brendshëm për një periudhë 5 vjeçare. Mbledhja e të dhënave në rrugë elektronike lidhet me krijimin nga ana juaj të regjistrave elektronike si:

Regjistër i fuqisë punëtore

Regjistër i punëmarrësit i detajuar për pagat, lejet, periudhat kohore.

Regjistri me listë prezencën në punë.

Në këto regjistra mblidhen të dhëna personale që lidhen me; *emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, adresën, vendbanimin, shtetësinë, nr. i sigurimeve shoqërore dhe informacione lidhur me datën e fillimit të punës, datën e mbarimit, tipin e kontratës së lidhur, detyra ose vendi i punës.*

Nga kontrolli u konstatua mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale të punonjësve nëpërmjet video survejimit CCTV. Nga grupi i kontrollit administrativ raportohet se në ambientin e punës, i cili rezultoi të jetë një korpus i madh me rreth 300-400 punonjës, në pika të ndryshme, përjashtuar ambientet e veshjeve, banjat etj, janë vendosur kamera të cilat monitorojnë në çdo kohë punonjësit. Njëkohësisht në hyrje të ambientit të punës dhe në mesin e tij janë vendosur monitorë të mëdhenj të ndarë sipas kamerave me regjistrim direkt. Sipas kontrolluesit qëllimi i vendosjes së tyre është për sigurinë e punonjësve për shkak të rrezikshmërisë së punës me makineri dhe alergjitë që krijohen nga materialet e lëkurës, si dhe për sigurinë e pronës.

Sa i përket mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave nëpërmjet kamerave CCTV konstatohet se nuk janë mbajtur parasysh kushtet dhe kriteret që parashikon ligji nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e Dhënave Personale” dhe udhëzimit nr.3 datë 5/03/2010 i ndryshuar i Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemit CCTV, kushte dhe kriteret që lidhen me ; përcaktimin e qëllimit të shprehur për këtë lloj mbledhje përpunimi të dhënash, përcaktimin e aksesit, kohës së ruajtjes së të dhënave , përhapjes së imazheve, pozicionit të vendosjes së kamerave, llojit të kamerave të përdorura, informimit të punonjësve, vendosjes së tabelave etj, kjo gjë është konstatuar shkelje e nenit 27 të ligjit dhe udhëzimit të mësipërm.

Grupi i kontrollit administrativ ka konstatuar gjithashtu faktin se kontrolluesi, “MITO By Caterina Firenze” sh.p.k. nuk ka plotësuar detyrimin ligjor për njoftim pranë Zyrës së Komisionarit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke e konsideruar shkelje të nenit 21 të ligjit 9887 dt.10/03/2008.

Nisur nga relacioni i grupit të kontrollit administrativ, procesverbali i mbajtur nga grupi i kontrollit administrativ për shkeljet e konstatuara, provat bashkëlidhur dhe gjithë argumentet e tjera rreth këtij kontrolli administrativ vlerësoj se: shkeljet e konstatuara nga grupi i kontrollit administrativ në procesverbalin e datës 11/09/2013 qëndrojnë dhe në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative;

REKOMANDOJ

Në zbatim të neneve 6, 18, 27,28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, udhëzimit nr. 3 datë 05/03/2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “Përpunimi i të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, kontrolluesi “MITO By Caterina Firenze” sh.p.k.;

1. Të merren masa për hartimin e një rregullore të shkruar për mbledhjen përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe kofidencialitetin e të dhënave personale, përdorimit të video-surveimit, regjistrim me kamera, (Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë).
2. Të bëjë informimin duke u vendosur tabelat informuese në vende të dukshme për përdorimin e video surveimit dhe përpunimin e të dhënash personale, sipas standardit të miratuar nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
3. Kryerja e këtyre detyrimeve të rëndësishme të kryhet brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij rekomandimi
4. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
5. Në rast mospërbushje të këtij Rekomandimi, Komisioneri vepron sipas neni 30, pika 2, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas të cilit ”Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

